



---

**VENDIM**  
**Nr. 78 Datë 22.10.2010**

**MBI**  
**LIDHJEN E KONTRATAVE TE NEGOCIUARA NGA SHOQERIA CEZ**  
**SHPËRNDARJA SH.A ME SHOQERITE CEZ AS DHE EFT AG**

Në mbështetje të nenin 9 të ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, pikës 2.10 te Vendimit te Bordit te Komisionereve nr.42 date 25.05.2009 “Rregullat dhe procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e CEZ Shpërndarja sh.a si dhe relacionet e Drejtorive teknike në ERE,

**Konstatoi se :**

Pas shqyrtimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga shoqeria CEZ Shpërndarja sh.a si dhe duke ju referuar Rregullave dhe procedurave standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a, ne procesin e negociimit, realizohet kushti i parashikuar në Rregulloren për procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a në pikën 2.10, ku thuhet se ERE miraton lidhjen e kontratës me kusht që çmimi i pranuar në kontratë të jetë më i ulët se ai i ofertës së paraqitur në tenderin e anuluar përpara se të fillojë procedura me negociim.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë kontratat e negociuara nga shoqëria CEZ Shpërndarja sh.a me shoqëritë CEZ AS dhe EFT AG sipas profilit:

**CEZ AS**

Periudha 1.1.2011 – 31.12.2011

Fuqia : 60 MW CBC 50% CEZ AS dhe 50 % CEZ Shperndarje

Sasia 525,600 MWh

Çmimi /njesi 49.74 Euro/MWh

**EFT AG**

Periudha 1.1.2011 – 31.12.2011

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve



---

Fuqia : 90 MW CBC 50% Cez Shpërndarja dhe 50 % EFT AG  
Sasia 788,400 MWh  
Çmimi /njesi 49.75 Euro/MWh

2. Ngarkohet CEZ Shpërndarja sh.a për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**